




GUIDA STUDENTORE

KRIJO UDHËTIMIN TËND!



"Guida Studentore", ose e njohur si "Mirësevjen Party", është një event i përvitshëm që mirëpret studentët e rinj në qytetin e Tiranës, duke u dhënë mundësinë të njihen me hapësiat e shumta që ofron qyteti për ta. Kjo iniciativë, e cila ka për qëllim të bëhet një ngjarje ikonë e Tiranës, synon të krijojë një ambient miqësor, përfshirës dhe tërheqës për të rinjtë, duke i bërë ata të ndihen të mirëseardhur.



Në tre vitet e fundit, "Guida Studentore" ka njohur një rritje të vazhdueshme në pjesëmarrje dhe është kthyer në një pikë referimi për të rinjtë dhe studentët që sapo fillojnë jetën e tyre në qytet.

Çdo vit kemi parë një rritje të konsiderueshme gjithashtu edhe në pjesëmarrjen e organizatave, bizneseve, universiteteve, bankave dhe institucioneve të tjera, të cilat ofrojnë shërbime dhe produkte për studentët e rinj.

Eventi ka arritur të krijojë një traditë dhe është kthyer në një mundësi për të rinjtë që të lidhen me organizatat dhe të bëjnë zgjedhje të informuara për shërbimet që i interesojnë

LOKACIONET E ZGJEDHURA



RRITJE E PJESËMARRËSVE

Një nga karakteristikat kryesore të "Guida Studentore" është zgjedhja strategjike e lokacioneve.

Çdo vit, eventit organizohet në hotspote rinore – vende të njohura dhe të frekuentuara nga të rinjtë, për të siguruar pjesëmarrje maksimale dhe një eksperiencë tërheqëse për studentët.

Kjo qasje ka ndihmuar në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve vit pas viti

Këtë vit, presim mbi 2000 vizitorë, duke përfshirë studentë të rinj, të cilët do të jenë shumë kuriozuar të njihen me mundësitë dhe shërbimet që ju, si kompani apo organizatë, mund të ofroni



Vizibiliteti i eventit dhe i të gjithë pjesëmarrësve do të realizohet në bashkëpunim me kompanitë, universitetet dhe organizatat pjesëmarrëse, duke krijuar një platformë të përbashkët ku do të promovohet çdo ofertë dhe shërbim që është i disponueshëm për të rinjtë. Përveç kësaj, një pjesë e rëndësishme e promovimit do të fokusohet në rrjetet sociale dhe mediave për të arritur një audiencë sa më të gjerë dhe për të rritur ndikimin e eventit.

50 kompani pjesëmarrëse
rreth 2000 të rinj që frekuentojnë eventin

www.guidastudentore.al

FTESË PËR PJESËMARRJE



Ju ftojmë që të bëheni pjesë e këtij event, duke përfituar nga ekspozimi i madh që ofron "Guida Studentore". Me rritje të vazhdueshme të pjesëmarrjes dhe një fokus të fortë në përfshirjen e organizatave lokale dhe ndërkombëtare, ky event është një mundësi unike për t'u lidhur me brezin e ri dhe për të ndihmuar në krijimin e një përvoje të paharrueshme për studentët e rinj të Tiranës.

Data 30 Tetor 2024

Bllok, Tirane

www.guidastudentore.al


Cfare u ofrohet pjesemarrresve?

Logo ne web
Logo ne postime online
Logo ne materialet e printuara

stende e dedikuar ne event

Logjistika ne stende

Video e dedikuar per organizaten/universitetin/biznesin





Faleminderit!

Bëhuni pjesë e “Guida Studentore”
dhe kontribuoni në mirëseardhjen e brezit
të ri të studentëve, duke ndërtuar një
komunitet të fortë dhe të ndërlidhur.